

VENDIM
Nr.755, datë 2.11.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË SHËRBIMIT TË SKANIMIT TË KONTEJNERËVE DHE
AUTOMJETEVE TË TJERA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË DHE MIRATIMIN E
BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET
SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurës ligjore për dhënie me koncesion të shërbimit të skanimit të kontejnerëve dhe automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë është Ministria e Financave.

2. Miratimin e bonusit prej 8% të pikëve për rezultatin teknik e financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Rapiscan Systems LTD”, SA (GFI).

3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha